



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.28/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike të kreditorit N. BI me numër të biznesit ..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Besnik Nikçi , kundër debitorit Kompania e Sigurimeve "E." me seli në rrugën ..., P., të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson A. K. , me objekt përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, gjegjësisht shqyrtimin e prapsimit, duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e vet, KPPP.nr.682/2022, të datës 29.06.2023, është shpallur jo kompetente, në pikëpamje lëndore, për të gjykuar në këtë çështje dhe pas formës së prerë të aktvendimit të cekur më lartë, shkresat e lëndës i ka dërguar Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e vet, PPP.nr.945/2021, të datës 10.08.2023, ka hapur konfliktin e kompetencës midis Gjykatës Komeriale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lëndën e ka dërgua në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës del se Përmbauesi Privat E. M., me seli në P., duke vepruar sipas propozimit të kreditorit B. N.-pronar i vetëm i Biznesit Individual "N." B. I., ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr ..., më datën 10.06.2021, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarues - tullit ekzekutiv - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Ekonomike III. EK.Nr. 196/2013, i datës 24.04.2017, i plotfuqishëm prej datës 02.10.2019 dhe i ekzekutueshëm prej datës 26.11.2019, me të cilën është detyruar debitori Kompania e Sigurimeve "E.", që kreditorit B. N. nga M., t'ia e paguaj borxhin në shumën prej 135,311.33 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar prej datës 03.01.2013, e deri në datën e përlogaritjes nga ekspertit financiar, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 6.556.75 €, si dhe shumën prej 624,00 €, në emër të përpilimit të propozimit për ekzekutim si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore sipas tarifës së Përmbauesve Privat.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor, duke deklaruar kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin në bazë të dokumentit përbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin kundër debitorit, pasi që N.P.T. "N.", sipas numrit të biznesit 70434068 me datën 17.06.2017 është shuar dhe në bazë të nenit 17 të LPP-së lidhur me nenin 95 të LPK-së, me shuarjen e personit shuhen edhe prokurat me të gjitha autorizimet e dhëna, duke i propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe të shfuqizojë urdhrin për lejimin e përbarimit.

Pas themelimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës kjo lëndë është bartur nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në Gjykatën Komerciale- Dhomën e Shkallës së Parë dhe më vonë është vendosur se kompetente sipas kësaj çështje është Gjykata Themelore në Prishtinë për shkak se selia e debitorit është në Prishtinë duke i dërguar lëndën kësaj gjykate e cila ka hapur konflikt.

Në rrethana të tilla të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, me vështrim në nenin 13 pika 1.1. të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, ku parashihet se përveç tjerash "Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv vetëm në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare dhe

kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore dhe për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate. Kjo gjykatë pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se duke u bazuar në faktin se palë në procedurë është personi fizik (është shuar subjekti juridik i kreditorit N. BI) dhe objekt i kontestit është pagesa e dëmit mbi bazën e aktgjykimi të gjykatës kompetente, i formës së prerë na data 02.10.2019, ndërsa propozimi për përmbartimi është paraqitur më 10.09.2021, nuk mund të jetë kompetencë e Gjykatës Komerciale. Kjo për faktin se Ligji Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale është publikuar në Gazeta zyrtare të Republikës së Kosovës / nr. 7 / 10 shkurt 2022, Prishtinë dhe kontesti është përfunduar në vitin 2019, nuk përmbushen asnjëra nga kriteret për të qenë kompetencë e Gjykatës Komerciale.

Andaj Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në nenin 5 pika 5 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore ku parashihet se "Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbartuese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbartuesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin ose ku gjendet selia e debitorit".

Gjykata Komerciale nuk ka juridiksion të vendos për rastet e përmbartimit, përveç atyre që parashihen dhe vendosën sipas Ligji Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbartim është Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, në pajtim me nenin 12.1 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për gjykatat i cili parasheh se "Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe" Për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.28/2023 datë 16.08.2023

Kryetari i kolegjit,
Beshir Islami